REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN

DATË/A:	15-09-2025
NGA/OD/FROM:	Drejtoria Komunale e Arsimit –Deçan z. Besnik Hulaj-Drejtori i DKA-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	THIRRJE PËR OFERTË

THIRRJE PËR OFERTË

Për dhënien me qira të bufes së shkollës

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Komunës, neni 5 dhe 6, si dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ të MASh për funksionimin e bufesë në institucionet arsimore, DKA - shpall thirrje publike për dhënien me qira të hapësirës së bufes së shkollës së mesme "Vëllezërit Frashëri" në Deçan .

1. Të dhënat e përgjithshme

- Objekti: Bufe e Gjimnazit "Vëllezërit Frashëri"
- Sipërfaqja: 24 m²Bufeja dhe 24 m²Pritorja.
- Adresa: Rr-Haki Povataj – Objekti i Gjimnazit
- Koha e qirasë: __1__ vitë (me mundësi vazhdimi sipas ligjit)



2. Kriteret për ofertuesit

- Të jenë persona fizikë apo juridikë të regjistruar në Kosovë, të jenë shtetas te republikës se Kosovës;
- Të posedojnë leje veprimtarie nga ATK për ushtrimin e gastronomisë;
- Të paraqesin dëshmi për aftësi financiare;
- Të ofrojnë produkte të shëndetshme dhe të mos shesin artikuj të ndaluar (pije energjike, cigare, alkool, etj.);
- Të respektojnë rregullat higjieno-sanitare dhe të sigurojnë kontrolle shëndetësore për punëtorët sipas ligjeve në fuqi;
- Të ofrojnë çmime të arsyeshme për nxënësit.
- Qiramarrësi i cili investon dhe e dëshmon investimin qoftë ne inventar apo në suvatime të bufes ne ambientin e jashtëm ose te brendshëm ka lehtësira ne mundësinë e vazhdimit te kontratës.

3. Mënyra e përzgjedhjes

Përzgjedhja e ofertuesit fitues do të bëhet sipas kritereve ligjore dhe parimit të ofertës më të favorshme ekonomike, duke u bazuar në:

- Shumën më të lartë të qirasë së ofruar;
- Përmbushjen e kritereve të përcaktuara më lart.

4. Afati dhe mënyra e dorëzimit të ofertave

- Ofertat dorëzohen në zarf të mbyllur në adresën: DKA / Sekretaria e shkollës)nga një kopje;
- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave : 01 /10/2025, ora15-00 ;
- Hapja publike e ofertave bëhet më datë : 02 /10/2025, ora 10-00 në zyrën e DKA :Nr10.
- **Ofertat duhet të jenë të mbyllura dhe të protokollohen në Njësinë për Administrimin e Dokumenteve.**

5. Dokumentet e kërkuara

1. Kopje e regjistrimit të biznesit;
2. Certifikata e numrit fiskal;
3. Dëshmi nga ATK që nuk ka borxhe tatimore;
4. Certifikata mjekësore për punëtorët;
5. Oferta financiare (shuma e qirasë mujore);
6. Lista e produkteve që do të ofrohen.

6. Të dhëna shtesë

- Vizita e hapësirës së bufes mund të bëhet çdo ditë pune nga ora 08-00 deri 16-00;
- Oferta do të jetë e hapur nga data 16-09-2025 deri më 01-10-2025 në ora 15-00
- Për informata shtesë, palët e interesuara mund të kontaktojnë në: 044626677.

z. Besnik Hulaj – Drejtor i Arsimit